



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERVBAL

#### I përmbledhur<sup>1</sup>

Tiranë, më 21.08.2020, ora 13:00

#### Drejton mbledhjen

Vitore Tusha – zv/Kryetare e Këshillit

#### Rendi i Ditës:

1. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e rishpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 21.08.2019 dhe Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019:

- Z. Shaqir Hasanaj

2. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatit të mësipërm.

#### Marrin pjesë:

- |                     |               |
|---------------------|---------------|
| 1. Vitore Tusha     | (zv/kryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare)     |
| 3. Arta Marku       | (anëtare)     |
| 4. Miranda Andoni   | (anëtare)     |
| 5. Saida Dollani    | (anëtare)     |
| 6. Ludovik Dodaj    | (anëtar)      |
| 7. Fatjona Memçaj   | (anëtare)     |
| 8. Arjan Qafa       | (anëtar)      |

#### Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm:

Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit

Merr pjesë, si i ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës

### HAPET MBLEDHJA

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226, pika 1, shkronja "d", neni 232, pika 2, neni 242, shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED-së për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe të subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED-ja disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhjeje, sipas ligjit.

**Vitore Tusha** – Deklaron të hapur mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të datës 21.08.2020.

Verifikon praninë dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit.

Informon se anëtarët e Këshillit janë të pranishëm, përveç zotit Ardian Dvorani, të cilin e ka lajmëruar për këtë mbledhje, duke marrë parasysh faktin që tashmë ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ. Në lidhje me këtë evidenton se me shkresën e datës 23 qershor, zoti Dvorani ka vënë në dijeni se nuk do ta ushtrojë kompetencën e kryetarit për shkak të situatës së paqartë juridike dhe faktike në të cilën ndodhej dhe që këtë njoftim e bën për të mos u bërë pengesë për veprimtarinë e Këshillit. Pas kësaj, Këshilli ka vijuar veprimtarinë e tij, duke miratuar disa akte normative dhe duke shqyrtuar shumicën e kandidaturave të dy vakancave.

Sqaron se nuk është kompetencë e saj të vlerësojë se kush do të thirret në mbledhjen e Këshillit, por duke pasur parasysh që tashmë ai është emëruar gjyqtar, e ka lajmëruar me të njëjtën procedurë si anëtarët e tjerë. Si dhe bën me dije se zoti Dvorani i është drejtuar Këshillit me një shkresë, në të cilën konfirmon se ka marrë dijeni për mbledhjen, ka parashtruar argumentet që përlligjin qëndrimin e tij si anëtar i këtij Këshillit dhe motivin e mospjesëmarrjes në këtë mbledhje. Gjithashtu, zoti Dvorani kërkon vendimmarrjen e domosdoshme të Këshillit për vijueshmërinë ose jo të ushtrimit të detyrës si anëtar i KED-së.

Bën me dije se të pranishëm në mbledhje janë edhe përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, ndërkohë nuk janë të pranishëm përfaqësuesi i Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë dhe përfaqësuesit e Komisionit të Ligjeve. Propozon që diskutimi i çështjes së mësipërme të bëhet në mbledhjen vijuese, në mënyrë që gjithsecili të ketë kohën e mjaftueshme në dispozicion.

Shtrohet për miratim rendi i ditës i paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit**, pasi diskutojnë për rendin e ditës, bien dakord të vijohet me shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e rishpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 21.08.2019 dhe Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019, zotin Shaqir Hasanaj dhe vendimmarrjen në lidhjen me lejimin/ndalimin e tij.

**Enio Haxhimihali** merr fjalën dhe parashtron: “Për sa i përket procedurës së thirrjes, ne do të donim të bënim disa rekomandime jo vetëm për këtë mbledhje, por në përgjithësi për mbledhjet.

Së pari, nga njoftimi publik i bërë në faqen tuaj zyrtare, rezulton se njoftimi është bërë në datën 19.08.2020 dhe duke pasur parasysh nenin 11/1 të vendimit 1 të KED-së, i cili thotë se njoftimi bëhet me shkrim së paku 5 ditë përpara datës që caktohet zhvillimi, ju rekomandojmë që në rastet kur nuk respektohet ky afat, të jepet një shpjegim pse nuk është respektuar afati, pra në të ardhmen kur nuk është e mundur të respektohet afati i mësipërm, të jepen arsyet, komentet që pse nuk respektohet.

Së dyti, në rendin e ditës së sotme, bazuar në rregulloren e KED-së dhe në praktikën e këtij organi, nuk është parashikuar miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Sigurisht që e mirëkuptojmë ngarkesën që ka qenë nga mbledhjen e kaluar, por përsërisim të njëjtin rekomandim, pra në rastet kur nuk arrihet dot që të miratohet procesverbali në mbledhjet e radhës, të jepen arsyet që të jenë të dokumentuara, pra edhe kjo të shpjegohet. Dhe përfitojmë nga rasti të sjellim në vëmendje të këtij organi të nderuar edhe gjetjen që ne kemi bërë në raportin drejtuar Kuvendit, pra në raportin për veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi gjatë vitit 2019, në faqet 21 - 26, ku themi që nuk duhen konfunduar procesverbalet e mbledhjeve me procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes, qëndrim ky që ne e kemi trajtuar me hollësi në pikat e raportit tonë drejtuar Kuvendit.

Së treti, për sa i përket njoftimit të bërë për mbledhjen e sotme, ashtu edhe për relacionet, pra jo vetëm për rendin e ditës, por edhe për relacionet, bëhet fjalë për shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin Shaqir Hasanaj për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, etj., etj., e rishpallur dy herë, edhe nga Kuvendi, edhe nga Presidenti. Siç rezulton dhe te procesverbali i përmbledhur i mbledhjes së KED-së së datës 17.07.2020, publikuar në faqen tuaj zyrtare, shqyrtimi i këtyre gjetjeve për të dyja vendet vakante, për të cilat kandidati ka kandiduar, është bërë në mbledhjen e datës 17.07.2020, nuk po i citoj, pra qoftë në relacionin e zonjës Marku, qoftë në relacionin e zonjës Saida Dollani dhe po në njoftimin e publikuar në faqen e KED-së, te vendimet rezulton se me vendimet 15 dhe 16 të KED-së është vendosur ndalimi i kandidimit të zotit Shaqir Hasanaj, i cili e ka goditur në rrugë gjyqësore dhe gjë e cila është pasqyruar dhe në pikat 44 dhe 43 të relacioneve, në pikën 44 të relacionit të zonjës Saida Dollani dhe 43 të zonjës Marku, ku thuhet që *“si dhe duke marrë në konsideratë vendimin nr. 67, datë 10.08.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit”*, pra përmendet edhe në relacionin e shpërndarë për mbledhjen e sotme vendimi i gjykatës.

Për sa më sipër, nuk rezulton që ndodhemi përpara shqyrtimit fillestar të gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatit Shaqir Hasanaj për të dyja vendet vakante për të cilat ai ka kandiduar, por përpara rishqyrtimit të këtij kandidati, pas ankimit që ky kandidat i ka bërë 2 (dy) vendimeve të KED-së 2020 në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ku kjo e fundit është shprehur me vendimin nr. 67, datë 10.08.2020. Pra, në kushtet kur në materialet e dërguara bashkëngjitur njoftimit për mbledhjen, përfshirë edhe të ftuarit e tjerë, pra jo vetëm anëtarëve të KED-së, por edhe institucionit tonë, institucionit të Presidencës, nuk na është përcjellë vendimi 67, të cilin e gjetëm vetëm sot në tavolinë, dhe ky vendim nuk është i publikuar as në faqen zyrtare të KED-së në rubrikën përkatëse, është cituar vetëm në pikën 33 të relacioneve, nuk po e citoj pra për ekonomi kohore. Në vlerësimin tonë edhe neni 228 i ligjit nr.115/2016 e përmend disa herë konceptin e vlerësimit, pra pika 5 thotë: *“Për zhvillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit dhe renditjes, relatori kryen detyrat shqyrtimin dhe verifikimin kërkon vlerësim dhe verifikim”*.

Në vlerësimin e institucionit tonë, relatori jo vetëm në këtë rast, por në të gjitha rastet kur hartohet një relacion, duhet të dalë me një konkluzion, pra jo thjesht të bëhet përcjellja e informacionit, por të dalë me një konkluzion. Pra, për sa i përket rasti konkret, jemi të mendimit se relacionet e përcjella për këtë mbledhje duhet të jepnin më shumë informacion dhe të analizojnë pikërisht çfarë do të bëjë KED-ja 2020 pas vendimit nr. 67, datë 10.08.2020 të Gjykatës së Apelit Administrativ, dhe jo të ridërgohet edhe një herë i njëjti relacion për shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin Hasanaj. Pra, në vlerësimin tonë, siç kemi thënë edhe më parë Këshillit, nuk duhet t'i bëhet thjesht prezantimi i dokumentacionit në mbledhje, por të dilet në konkluzione konkrete, gjë që do të rriste njëkohësisht edhe nivelin e transparencës.

Së katërti, pavarësisht se në mbledhjen e datës 17.07.2020 nga ana e përfaqësuesit të institucionit tonë të Avokates së Popullit, zonjës Ballanca, u rekomandua që të përfshihej në materialet për mbledhjen edhe komunikimi i relatorëve me kryetarin e KED-së, si dhe me kandidatin për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, rekomandim i cili është pranuar nga KED-ja, konstatojmë se ky rekomandim yni është pasqyruar vetëm pjesërisht. Pra, vetëm në njërin nga relacionet përmendet data 18.08.2020, kur relacioni i zonjës Marku i është përcjellë zonjës Tusha, ndërkohë që në relacionin tjetër nuk përmendet fare.

Pra, për sa më sipër, ne ripërsërisim këtë rekomandim, me qëllim që në mbledhjet e ardhshme të na përcillet i plotë komunikimi i relatorit me kryetaren e KED-së, kërkesë kjo e parashikuar si nga ligji nr.1165/2016, ashtu edhe nga pika 33 e vendimit nr. 4 të KED-së, të ndryshuar, komunikimi me kandidatin për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, si dhe dokumentacioni që provon dërgimin e relacionit dhe dokumentacioni shoqërues anëtarëve të

KED-së, e parashikuar në këtë pikë. Pra të thuhet në një paragraf që relatori me *e-mail* apo me shpresë, apo si ka qenë mënyra e komunikimit, numër aq, datë kaq, i komunikoi kandidatit në datën kaq materialin përkatës. Pra, këto gjëra sërish mungojnë.

Për sa i përket çështjes që ju shtruar sot për diskutimin ose jo të kërkesës që zoti Dvorani ka bërë, ne konstatojmë se nuk është në rendin e ditës një kërkesë e tillë, institucionit tonë nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për këtë gjë. Pra do të rekomandojmë të respektohet procedura e parashikuar nga rregullorja e KED-së që materialet që shqyrtohen në mbledhje të njoftohen, të jenë në rendin e ditës, të shpërndahet materiali paraprakisht, ashtu si do të jetë e të na vihet edhe ne në dispozicion”.

**Vitore Tusha** për dërgimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ sqaron se Avokati i Popullit ka qenë palë në procesin gjyqësor në cilësinë e personit të tretë, prandaj ka të njëjtat të drejta për t’u pajisur me kopje të vendimit, megjithëse siç e theksoi ai, një kopje e vendimit i është vendosur në tavolinë secilit. Jo vetëm kaq, por përfaqësuesi i KED-së ka marrë pjesë në gjyq dhe disa herë, pas shpalljes së vendimit, është paraqitur në Gjykatën e Apelit, ku ka kërkuar të pajiset me një kopje të vendimit të arsyetuar.

Lidhur me respektimin e afatin 5-ditor për thirrjen e mbledhjes, i cili është afat që duhet respektuar, me të njëjtën përgjegjësi ligjore për të përfunduar sa më shpejt procedurën për verifikimin e kushteve të kandidatit në afate të shpejta, njoftimi është bërë në një afat më të shkurtër. Shpjegon se për datën ka komunikuar paraprakisht me Avokatin e Popullit, siç ka komunikuar me të gjithë anëtarët, duke mos pasur asnjë kundërshtim dhe duke konfirmuar prezencën e zotit Enio si përfaqësues.

Sqaron se për sa i përket përfshirjes në rendin e ditës të miratimit të procesverbalit, për shkak të kohës së shkurtër nga një mbledhje tek tjetra, ishte e pamundur të realizohej përmbledhja dhe respektimi i kritereve për miratimin e tij.

Për relacionin sqaron se përmban gjithçka ka pasur relacioni i mëparshëm, por edhe fakte shtesë, si data kur i është komunikuar relacioni nga KED-ja dhe fakti që kandidatit në datën 30.07.2020 i janë vënë në dispozicion, sipas kërkesës së tij, të gjitha materialet që janë administruar në dosje. Për sa kohë që vendimi i parë i KED-së është shfuqizuar, duke qenë se kjo është një çështje e re, nga e para, nuk shihet me vend përgatitja e një relacioni të shkurtuar, vetëm për shkaqet e vendimit të Gjykatës së Apelit, por këto të fundit përfshihen në relacionin e plotë.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën: “Për rendin e ditës për mbledhjet që zhvillohet sot nga ky Këshill, jemi dakord dhe do të jemi këtu për të dëgjuar diskutimet sipas njoftimit të ardhur mbi shqyrtimin e gjetjeve të kandidaturës së zotit Shaqir Hasanaj për dy vende vakante, një të Presidentit të Republikës dhe një të Kuvendit. Ky është kandidati i fundit që ngelet në proces verifikimit nga Këshilli për këto dy vakanca. Për sa i takon njoftimit tjetër që jemi vënë në dijeni përmes medias, dhe publikimeve të mediave elektronike se ka një kërkesë apo një njoftim të z.Dvorani, më lejoni të jap qëndrimin tonë paraprak se kjo çështje nuk ka asnjë lëndë më për t’u shqyrtuar nga Këshilli dhe për më tepër Këshilli nuk ka asnjë lloj kompetence. Këshilli nuk ka lëndë dhe nuk ka asnjë kompetencë. Të gjithë jeni në dijeni se në datën 10 mars u emëruan nga Presidenti tre gjyqtarë të Gjykatës së Lartë. Në datë 13 mars ata bënë betimin përpara Presidentit dhe morën detyrën. Për këtë arsye pritej formalisht që zoti Dvorani duhet të bënte dorëzimin e detyrës si anëtar i Gjykatës së Lartë. Këtë nuk e realizoi për këto arsye Presidenti i Republikës është investuar me një shkresë të datës 10.04.2020, nr. 1117/2 prot, drejtuar KLGj-së, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe për dijeni Kuvendit të MSh, anëtarëve të KED-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Avokatit të Popullit. Këtë shkresë Presidenti si organ dhe i emërtesës që kishte bërë emërimin e zotit Dvoranit si anëtar i Gjykatës së Lartë, kishte konstatuar dhe përfundimin e mandatit të këtij gjyqtari që prej shkurtit 2014, ishte autoriteti i vetëm që mund ta kujtonte KLGJ-në që të tregonte kujdes dhe të shqyrtonte mbi faktin se një mandat i një

gjqytari kishte përfunduar ose një detyrë si gjyqtar i Gjykatës së Lartë po ushtrohet përtej të gjitha rregullave kushtetues. Në këtë shkresë Presidenti jo më kot është marrë edhe me ndikimin që kishte ky fakt mbi anëtarësinë dhe pjesëmarrjen në KED. Sepse Presidenti është dhe organi që ka hedhur shortin që ky Këshill u formua. Shorti për zgjedhen e KED hidhet nga Presidenti ose Kuvendi dhe nëse do të hymë në diskutime se kujt i takon plotësimi apo interpretimi mbi këtë boshllëk ligjor që citon zoti Dvorani në kërkesën/njoftimin e publikuar në media, nuk ka organe të tjera për të vendosur përveç KLGj-së, (e cila e ka marrë tashmë vendimin e saj) dhe Kuvendi dhe Presidenti, që janë organe ligjbërëse dhe përgjegjëse për hedhjen e shortit. KED-ja nuk ka asnjë kompetencë as kushtetuese dhe as në ligjin për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Më gjeni një dispozitë të vetme që Këshilli mund të diskutojë dhe mund të marrë vendim për vijimësinë, vazhdimësinë e mandatit të një organi apo të një anëtari të Këshillit. Nuk ka. Kështu që n.q.s. zoti Dvorani dëshiron të vijojë të jetë pjesë e Këshillit, këtë kërkesë mund t'ua drejtojë organeve që unë citoj, KLGj-së, Presidentit, Kuvendit. Nuk ka punë me KED, sepse Këshilli vetë nuk vendos dot kush janë anëtarët e tij. Ata zgjidhen me short, dhe periudhën kur hidhet shorti e ka përcaktuar Kushtetuta. Kush e hedh shortin me 5 dhjetor e ka caktuar Kushtetuta, kush e hedh shortin midis datës 5 deri me 10 dhjetor e ka caktuar Kushtetuta. Prandaj ku hyn KED-ja këtu për të marrë në shqyrtim një kërkesë të tij?! Ajo që dua shtoj është se KED-ja ka funksionuar nën drejtimin e zv/kryetarit, jo për shkak se zoti Dvorani bëri një njoftim: “Shiko se unë kam një situatë të paqartë, vazhdoni ju”, por për shkak se ligji thotë: “Në rast mungese për çdo lloj arsye kryetari zëvendësohet nga zv/kryetari”. Jo se thotë Dvorani vazhdon zv/kryetari të drejtojë mbledhjen e Këshillit. Kështu që në këtë kërkesë/njoftim e gjejmë pa vend të shtruar në këtë tryezë të KED-së dhe në vendin jo të duhur. Kështu që, Këshilli nuk ka çfarë të diskutojë, qoftë më vonë. Ajo që na krijoi zoti Dvorani me këtë kërkesë është deri diku dëmtim i punës së Këshillit dhe sinjerisht na vjen keq, ose mbulim i situatës që prapë 2 vakanca në gjykatën kushtetuese nuk po plotësohen. Më shumë media, siç doli dhe sot, po trajtojnë prapë këtë çështje sesa faktin që kemi Gjykatë Kushtetuese të paplotësuar. Kështu që unë mendoj se KED-ja nuk ka kompetencë ta shqyrtojë jo vetëm sot por as në mbledhjet e ardhshme këtë çështje, sepse nuk ja ngarkon ligji dhe Kushtetuta këtë detyrë. Dhe kjo çështje ka marrë një zgjidhje nga organi që ka hedhur shortin për zgjedjen e KED, që është Presidenti i Republikës. Presidenti ka cituar në shkresën e tij në fund që në vijim KED-ja do të duhet të vijojë rregullisht nën drejtimin e zv/kryetares. Nëse zoti Dvorani, ashtu siç ka shprehur në disa kërkesa të tij të dala edhe publikisht nuk është dakord me qëndrimin që ka mbajtur Presidenti kur u investua me një kërkesë drejtuar KLGJ-së për të shprehur për përfundimin e mandatit të tij, z.Dvorani do të duhej të kishte shkuar në Gjykatë edhe për këtë akt të Presidentit edhe për vendimin e KLGJ-së që trajtoi rastin e tij. Por jo, të dyja këto akte i ka pranuar, dhe pse për këto akte (shkresën e Presidentit) ai ka marrë njoftim kur ishte kryetar i KED edhe nga KLGJ-ja, duke marrë detyrën e anëtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, funksion që ia ka dhënë KLGJ-ja.”.

**Vitore Tusha** sqaron se nuk është filluar asnjë diskutim rreth thelbit të kësaj çështjeje deri në këtë moment. Kompetencat e kryetarit janë ushtruar sipas Kushtetutës dhe ligjit në momentin që zoti Dvorani ka informuar Këshillin në lidhje me mosvijimin e këtij funksioni, sa kohë që KLGJ-ja nuk ka përcjellë ndonjë akt/vendim në KED për këtë çështje.

U prezantua para Këshillit situata, pra që është marrë një vendim, dhe kjo çështje nuk është bërë pjesë e rendit të ditës dhe as nuk ishte parashikuar si e tillë. Për të bërë pjesë të rendit të ditës diskutimin për këtë çështje, rregullat janë të përcaktuara në nenin 16 të rregullores, sipas së cilës duhet të vendosin 2/3-at e anëtarëve.

Fton anëtarët të shprehin mendimin e tyre për përfshirjen ose jo të kësaj çështjeje në rendin e ditës.

**Anëtarët** diskutojnë dhe shprehen se janë dakord të vijohet me rendin e ditës të përcaktuar.

**Saida Dollani** përpara se të relatojë sqaron në lidhje me problematikën që ngriti Avokati i Popullit se për sa i përket pasqyrimin të komunikimit institucional ndërmjet relatorit dhe kryetarit apo zëvendëskryetarit në mungesë, çdo gjë gjendet e shkruar dhe është në rrugë elektronike. Aktet në çdo moment mund të verifikohen, pasi gjenden të printuara dhe në fashikullin përkatës. Nuk parashikohet në asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore që relatori të ketë detyrimin për të komunikuar paraprakisht me Avokatin e Popullit se kur është njoftuar kandidati, mjafton që të jetë njoftuar, sepse, dhe jo pa qëllim, ligjvënësi nuk e parashikon, sepse nuk ka asnjë pasojë për sa u përket afateve, pra pas marrjes së relacionit kandidati nuk ka të drejtë të prapësojë. E drejta e tij për t'u njoftuar është realizuar.

Lexon përmbajtjen e komunikimit elektronik.

Vijon me relatimin dhe sqaron: “Përpara jush keni një relacion, ashtu siç e tha edhe zonja zëvendëskryetare, të ri, pas vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit. Elementet e pasqyruara në pikat 31, 32, 33 dhe 34 janë faktet e reja, që kanë të bëjnë me procedurën pas vendimmarrjes së parë të këtij Këshilli, vendimmarrje tashmë e prishur nga Gjykata Administrative e Apelit dhe e rikthyer sërish në KED. Duke qenë se nga vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit, ku Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka qenë palë, ndërsa personi i tretë ka qenë Avokati i Popullit dhe Presidenti i Republikës për çka dhe në këndvështrimin ligjor të njoftuar rregullisht për vendimmarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit dhe me shkaqet e prishjes së vendimit të KED-it, si relatores e re, e cila ka konfirmuar të gjitha veprimet e dy relatorëve të mëparshëm, që kanë qenë zoti Islamaj dhe zonja Tusha, por duke bërë dhe veprime pas marrjes, pra pas rënies së shortit dhe duke parë të gjitha aktet që ndodhen në dosje, edhe pas prishjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, e cila vetëm për procedurën e votimit e ka prishur vendimin, kam çmuar dhe çmoj se procedura e verifikimit të kushteve për zotin Shaqir Hasanaj është e plotë, prandaj kam proceduar me relacionin, duke sjellë në vëmendjen tuaj të gjitha aktet që ndodhen në fashikull, gjetjet në bazë të nenit 234-235-236-237 të ligjit nr. 115/2016 për sa i përket verifikimit dhe kushteve”.

Për sa u përket kushteve të verifikimit të nenit 235, që kanë të bëjë me pasurinë e zotit Shaqir Hasanaj, si dhe figurës dhe integritetit që parashikon neni 236, sqaron se janë verifikuar. Më tej ndalet tek kriteret e nenit 237, i cili referon në ligjin e Gjykatës Kushtetuese dhe që përshkruhen në pikën 38 të relacionit dhe që lidhet konkretisht me kushtin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetve të fundit nga data e kandidimit. Po ashtu, edhe në lidhje me kushtin e kandidimit të përcaktuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos të ketë marrë masë disiplinore në fuqi, prej informacionit të përcjellë e të administruar nuk rezulton se kandidati Shaqir Hasanaj të jetë rikthyer në detyrën e gjyqtarit dhe nuk rezulton që vendimi i shkarkimit nga detyra të ketë qenë objekt revokimi nga organi administrativ apo objekt shfuqizimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në mënyrë fizike ka ardhur një kërkesë nga zoti Hasanaj para KED-ës, e cila është vënë në dispozicion, për të bërë pjesë të shqyrtimit edhe dokumente që janë marrë nga KLGJ-ja, të cilat janë paraqitur edhe përpara Gjykatës Administrative të Apelit, e cila nuk i ka marrë parasysh.

*E-mail*-i i dërguar nga kandidati, i printuar në formë shkresore dhe i protokolluar me nr. 177 Prot., datë 30.07.2020, gjendet i administruar në dosjen e kandidatit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me aktin shkresor nr.177/1, datë 30.07.2020, i ka kthyer përgjigje kandidatit Shaqir Hasanaj, duke i bashkëlidhur kopjo të dosjes së kërkuar prej tij.

Vendimi nr. 15, datë 17.07.2020 i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është ankimuar nga kandidati Shaqir Hasanaj në Gjykatën Administrative të Apelit, me kërkimet (objekti):

“Pavlefshmërinë e vendimit nr. 15, datë 17.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për ndalimin e kandidimit të z. Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019”.

Pavlefshmërinë e vendimit nr. 16, datë 17.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për ndalimin e kandidimit të z. Shaqir Hasanaj në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019”.

Konstatimin e shkeljes në neneve 6 dhe 8 të KEDNJ-së si rezultat i ndalimit të kandidimit për anëtar të GjK-së.

Detyrimin e palës së paditur, KED-së, të përfundojë procedurën për z. Shaqir Hasanaj për vakancën e shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

Detyrimin e palës së paditur, KED-së, të përfundojë procedurën për z. Shaqir Hasanaj për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019”.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 67, datë 10.08.2020, duke evidentuar se arsyetimi i vendimit dhe shkaqet e ndalimit të tij nuk janë në harmoni dhe përputhje me vendimmarrjen e gjithsecilit anëtar të KED-së, “pasi kuorumi i duhur për vendimmarrjen e ndalimit të kandidimit të tij është me shumicë votash, 6 pro, dy kundër vetëm për kriterin që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi të parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Kriter i cili është arsyetuar nga KED-ja në vendimet objekt ankimi nga pika 66 deri në pikën 75. Ndërsa në lidhje me kriterin ndalues të arsyetuar në vendim si një tjetër shkak për ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të ushtrimit të detyrës si Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës, të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, rezulton se ai është një kriter që nuk është ndalues në referim të mënyrës së votimit të këtij kriteri, katër vota pro lejimit dhe katër vota kundër lejimit, çka në interpretim të dispozitave ligjore përbën shkak për cenimin e procesit të rregullt ligjor, pasi vendimmarrja, arsyetimi i vendimit rezulton ndryshe nga mendimet e dhëna me shkrim, nga mënyra e votimit të anëtarëve të KED-së, duke pasqyruar në fakt dy shkaqe për ndalimin e kandidimit, kur, në fakt, votimi rezulton me gjashtë vota kundër vetëm për një kriter ndalues, të kandidatit Shaqir Hasanaj, për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të padisë.

Shfuqizimin e vendimit nr.15, datë 17.07.2020 të nxjerrë nga i padituri, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Shfuqizimin e vendimit nr.16, datë 17.07.2020 të nxjerrë nga i padituri, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Pushimin e gjykimit të çështjes për kërkimet e tjera të padisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”

Parashtron se gjetjet në procedurën e verifikimit lidhen me pozicionin që ka mbajtur si këshilltar i Presidentit, si dhe me masat disiplinore: vërejtje me paralajmërim dhe shkarkim nga detyra e gjyqtarit.

**Vitore Tusha** pyet nëse anëtarët kanë pyetje.

**Miranda Andoni** pyet në lidhje me marrjen e provave sipas kërkesës.

**Vitore Tusha** sqaron se janë njohur me disa dokumente, të paraqitura nga kandidati, të cilat ju janë shpërndarë të gjithëve dhe përmbajtja e tyre duhet të shihet me vëmendje.

**Anëtarët** e Këshillit diskutojnë në lidhje me mënyrën e marrjes së provave të paraqitura një ditë më parë nga kandidati dhe formën e tyre, duke iu referuar kriterëve ligjore.

**Enio Haxhimihali** ndërhyr për të bërë një pyetje: “Pyetja ime ka të bëjë me relatimin që u bë, i cili në një pjesë të mirë iu kushtua dokumenteve që gjetëm sot mbi tavolinë: a janë pjesë e relacionit që na u dërgua për mbledhje, apo jo?”

**Saida Dollani** përgjigjet: “Ju nuk më paskeni dëgjuar fare, unë e thashë në fjalën time që nuk janë pjesë e relacionit, sepse kanë ardhur dje dhe relacioni përpara jush ka qenë shumë më parë. Fizikisht në formën e kërkuar kanë ardhur ditën e djeshme. Po ashtu e thashë, nuk është detyrim ligjor, unë fola shumë gjatë, ju nuk më keni kuptuar”.

**Enio Haxhimihali** merr fjalën: “Unë ju kam kuptuar shumë mirë, por doja të evidentojmë në procesverbal faktin që relacioni i shpërndarë nuk përfshin materialet që kanë ardhur më pas. Pra, një nga zgjidhjet mund të ishte shtyrja e mbledhjes për përfshirjen e këtyre materialeve në relacion, mund të kishte zgjidhje të tjera, prandaj unë doja që ky koment të përshihej në procesverbal. Ju siguroj që ju kam dëgjuar me gjithë vëmendjen e duhur.”

**Saida Dollani** merr fjalën dhe pyet: “A mund të më jepni bazën ligjore të më vijë në ndihmë, se si mund të shtyhet për ta marrë në shqyrtim? Unë do të doja të më ndihmonit vetëm me bazën ligjore të kësaj që tha përfaqësuesi i Avokatit të Popullit”.

**Enio Haxhimihali** merr fjalën: “Kjo që unë thashë lidhet pikërisht me ato pikat që u parashtruan në fillim, afatet e mbledhjes etj., jo më kot themi, që ka nevojë për një kohë të caktuar, sepse ndodh që vijnë dokumentet për të cilat KED-ja mund të marrë.”

**Vitore Tusha** tërheq vëmendjen që të mos bihet në përsëritje.

**Enio Haxhimihali** merr fjalën: “Për sa kohë diskutohet rreth 15 min, pikërisht për dokumentet që kanë ardhur pas relacionit, doja të dija si do të procedojë KED-ja në këto raste, ato do të përfshihen në relacion? Kjo ishte pyetja ime.”

**Vitore Tusha** sqaron se është në vlerësimin e KED-së mënyra e procedimit për marrjen e provave të reja dhe përfshirjen e tyre në relacion, çka do të sillte shtyrjen e kësaj mbledhjeje, apo të vijohet me vlerësimin e tyre. E rëndësishme është që të gjitha dokumentet e paraqitura nga kandidati dhe komentet e tij ligjore u bënë pjesë e diskutimit.

**Anëtarët** bien dakord.

**Arta Marku** merr fjalën në lidhje me vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, e rishpallur në datën 27.09.2019 për të njëjtin kandidat. Gjetjet janë identike me ato që u prezantuan nga zonja Dollani. Edhe vendimi i Gjykatës Administrative për të njëjtin shkak ka ndodhur.

**Anëtarët** nuk kanë pyetje ose sqarime.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën: “Ky është momenti që unë si përfaqësues i Presidentit, do të largohem, pasi Këshilli do të vazhdojë diskutimet dhe vendimmarrjen e tij. Duke qenë se Institucioni i Presidentit të Republikës në rastin e zotit Shaqir Hasani ka qenë institucion pjesëmarrës në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit dhe ka shprehur qëndrimin e tij, më duhet të bëj një koment procedural për KED. Pikërisht për faktin që vendimet e KED-së për të gjithë kandidatët duhet të jenë shumë mirë të arsyetuara për sa u takon gjetjeve dhe vlerësimeve për kandidatët. Ky Këshill i ka të gjitha kapacitetet për të mbajtur një qëndrim të unifikuar referuar faktit që për të njëjtin pozicion, për të njëjtën bazë



ligjore emërimi, ka mbajtur qëndrim në vitin e kaluar (2019), për kandidatin Metani që sot ushtron detyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kështu që sa më i mirë të jetë argumentuar vendimi i KED-së, le të jetë si të jetë vendimmarrja e Këshillit, por duhet të jetë i arsyetuar plotësisht, në mënyrë që kandidati të njihet në mënyrë shteruese me rrethanat e faktit, dhe vlerësimin e tyre prej KED-së se cilat janë ato fakte që Këshilli vendos dhe e lejon të vijojë të kandidojë apo e ndalon kandidimin. Ju uroj punë të mbarë!”

**Vitore Tusha** deklaron të mbyllur mbledhjen dhe vijimin me vendimmarrjen.

**SEKRETARE**  
**Rediona MYRTJA**

**ZV/ KRYETARE**  
**Vitore TUSHA**